



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 4/14

Prishtinë, më 29.12.2014, ora 11:35

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Bojan Mitić, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Jakup Krasniqi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Agim Krasniqi - Drejtor i Departamentit të Buxhetit Qendror në MF, monitorues nga KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i Raportit me amendamente të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;**
 - 2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar nga data 01.01.2015 deri më 31.12.2015;**
 - 3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Komisioneve tjera të përhershme lidhur me Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.**
-
- 1. Miratimi i Raportit me amendamente të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015**

Kryetari – sqaroi se amendamentet e komisionit janë miratuar me dy vota Kundër (Visar Ymeri dhe Donika Kadaj-Bujupi), ndërsa në takim ka munguar Jakup Krasniqi. Po ashtu në takimin e kaluar, kemi dhënë pëlqimin, që të përkrahim propozimet e Ministrisë së Financave, lidhur me shkurtimet buxhetore që i ka paraqitur ministri dhe këto propozime i ka dërguar ministria dhe janë shëndrruar në amendamente të komisionit. Megjithatë, duke pasur parasysh kohën e shkurtër në përgatitjen e raportit,

janë bërë dy gabime në shifra në amendamentin 11 dhe 18. Në amendamentin 11, pika 29, shuma 11,336,657, duhet të korrigjohet në shumën 11,328,257 dhe amendamenti 18 nën-pika 15.1, shuma 2,843,316, duhet të korrigjohet në shumën 2,855,479. Po ashtu duhet të shqyrtojmë dhe të deklarohemi edhe për dy amendamentet, e propozuara nga katër deputetë (Vjosa Osmani, Armend Zemaj, Doruntina Maloku dhe Arben Gashi), që kanë ardhur të protokolluara, pasi që ne kemi përfunduar punën si komision, në shqyrtimin e projektligjit.

Komisioni njëzëri miratojë ndryshimet në amendamentin 11, pika 29 dhe amendamentin 18, nën-pika 15.1, siç u propozuan nga kryetari i komisionit.

Safete Hadergjonaj – theksoi se ka qenë praktikë e punës në Komision, që raporti final me amendamente i komisionit për një projektligj, pasi që të kalojnë procedurat e shqyrtimit në komisionet tjera të përherëshme dhe pranimit të rekomandimeve të tyre, të votohet formalisht edhe njëherë në komision, para se i njëjti të procedohet për miratim Kuvend. Sa i përket propozimeve të Ministrisë së Financave, ne jemi pajtuar me propozimet për shkurtimin e buxhetit për blerjen e veturave dhe paisjet për teknologjinë informative, por nuk e kemi pasur materialin përpara për të parë ndryshimet konkrete që janë bërë në secilën ministri. Tek investimet kapitale, sipas propozimit të ministrisë ne kemi aprovuar shkurtimet për 10%, për të shtuar pozicionin e shtresimit të rrugëve dhe ndryshimet tjera në investimet kapitale, nuk kemi miratuar. Çdo ndryshim i brendshëm që bëhet apo gabim që lëshohet, dhe nuk e ka votuar komisioni, duhet që të votohen formalisht në komision, para se raporti final të procedohet në seancë për miratim.

Kryetari – projektligji është shqyrtuar me urgjencë dhe si rezultat janë shmangur procedurat e rregullta në shqyrtim dhe amendamentim.

Donika Kadaj-Bujupi – po pajtohem që amendamentet e deputetëve të trajtohen në raportin final, sepse prapë munden me u kthye për shkak të implikimeve në komisionet përkatëse që po mbajnë tani takime. Po e kuptojmë se jemi në një situatë të ngutisë, por ne si komision nuk guxojmë të bëjmë gabime dhe shkelje ligjore dhe mendojë se kemi mundur të shtyjmë shqyrtimin e buxhetit në muajin janar, dhe kjo ka ndodhur edhe në të kaluarën, për të pasur kohë më shumë me shqyrtue më ngadalë dhe në mënyrë më cilësore. Sa i përket amendamentit 43 të deputetit Rustem Berisha, në raport figuron pa përkrahjen e komisionit, dhe realisht ky amendament ka përkrahje të pjesshme të komisionit dhe duhet modifikuar për tu theksuar kjo dhe për tu përfshirë ndryshimet e miratuara.

Kryetari – sqaroi amendamenti i deputetit Rustem Berisha, është përkrahur pjesërisht nga komisioni, dhe kërkesat që janë përkrahur janë pjesë e amendamenteve, siç është rasti me projektin “Beteja e Koshare”, ku janë ndarë 50,000 euro dhe është pjesë e amendamentit 20 që të bëjë me ndryshimet në buxhetin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ndërkaq, projektet tjera të përkrahura, që është ndarja e 50,000 eurove për projektin “Memorialet e dëshmorëve të UÇK-së në Penuhë dhe 200,000 euro për projektin “Vazhdimi i punimeve në Kompleksin Memorial “Beteja e Koshares” dhe janë pjesë e amendamentit 35. Ne si komision, nuk mund të themi me përkrahjen e komisionit, se nuk është përkrahur amendamenti në tërësi, por unë do të sqarojë në seancë vendimin e komisionit për përkrahjen e kërkesave.

Latif Gashi – amendamenti i deputetit Rustem është përkrahur pjesërisht dhe ju si kryetar duhet të sqaroni në seancë përkrahjen e kërkesave dhe përfshirjen e tyre në amendamentet përkatëse.

Visar Ymeri – në këso raste, siç e kemi me deputetin Rustem Berisha dhe deputeten Alam Lama, duhet të njoftohen deputetët për pranimin e pjesërishëm të tyre, që të tërheqin amendamentet, pasi që kjo krijon probleme në votim.

Bojan Mitic – kërkojë që edhe njëherë të shqyrtohen kërkesat e listës serbe. Është fjala për mjete shtesë, për Ministrinë për Administrimit të Pushtetit Lokal, për 900,000 euro. Po ashtu shuma prej 1 milion euro që është i destinuar për veriun e Kosovës, të mbetet në këtë ministri. Kërkesa e dytë ka të bëjë me buxhetin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, që është kërkuar që 3 milion euro për investime kapital, të parapara për bashkëfinancim me komunat në Veri të Mitrovicës, të mbeten në ministri. Si dhe të rritet buxheti në ministrinë për komunitet dhe kthim në projektet kapitale dhe buxheti total për këtë kategori të jetë 7.640.000 euro. Kjo është edhe pjesë e marrëveshjes me koalicionin.

Kryetari – çdo amendament i propozuara duhet të jenë i precizuar dhe të tregohet ku merren mjetet dhe ku shkurohen, pasi që ne e dimë se nuk mund ti rrisim kufijtë buxhetor.

Agim Krasniqi – sa i përket kërkesës së MAPL, nëse është urgjente, do të realizohet nga rezerva buxhetore. Sa i përket ministrisë për komunitet dhe kthim me amendamentet e propozuara janë ndarë 400,000 euro.

Latif Gashi – zotëri Bojan ju keni qenë në takim kur janë diskutuar kërkesat në praninë e ministrisë së financave dhe është thënë se ekziston marrëveshja në qeveri për buxhetin e kësaj ministrie, dhe ju jeni pajtuar me këtë. Nëse shohim shkurtimet që janë bërë me propozimet, nuk do ta përkrahu, por duke ditur se buxheti është i mundësive dhe jo i nevojave, vota është për.

Bojan Mitic – në mbledhjen e fundit jam pajtuar për 400,000 euro. Por, nuk kemi vendosur për shumën 3 milion euro që e përmenda më herët.

Fikrim Damka – në takimin e kaluar kam kërkuar, që ndahet buxheti dhe kodet e veçanta për secilin komunitet. Me amendamentet e propozuara është rritur buxheti i ministrisë për komunitete dhe kthim në investimet kapitale dhe pasi që ka pasur kohë me u rritë buxheti për këtë ministri, është dashur të ndahen kodet, dhe të dihet se sa është buxhet i secilit komunitet, në këtë ministri. Një çështje ka të bëjë me propozimet e ministrisë së financave, ku është bërë shkurtimi i buxhetit në Agjencionin e Informacionit dhe unë besoj se duhet me mbyll këtë agjencion sepse nuk ka me pas kurrfarë pune dhe nuk ka me realizuar asnjë projekt.

Kryetari – me rastin e arsyetimit të amendamentet të ministrisë për komunitet dhe kthim, në seancë, do të kërkojë që qeveria, të bëjë kriteret për ndarjen e mjeteve buxhetore për secilin komunitet.

1.1. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara nga deputetët, Vjosa Osmani, Armend Zemaj, Doruntina Maloku dhe Arben Gashi

Kryetari – sqaroi se amendamenti 1 ka të bëjë me atë që në buxhetin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, tek kategoria pensioneve “kontribut pagues të moshës shtohet teksti në vijim: Përfshirë pensionistët kontributdhënës për vitet 1989-1999, si punëtorët e arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerët që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës. Amendamenti 2, kërkon që në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë, për listën e barërave esenciale të rritet shuma prej 9 milion euro. Sa i përket amendamentit të parë, mund të rregullojmë në pjesën tekstuale të projektligjit.

Latif Gashi – sa i përket amendamentit 1, mendojë se në këtë fazë nuk mund të realizohet sepse duhet që komisioni qeveritar, të bëjë verifikimin e saktë të përfituesve dhe të përcaktohet kostoja buxhetore dhe pastaj të përfshihet në ligjin e buxhetit. Një formë e tillë e trajtimit dhe ndarjes së buxhetit ka ndodhur edhe me rastin e shqyrtimit të kërkesave për kategoritë tjera të luftës, siç kanë qenë rasti me veteranët apo ish të burgosurit politik.

Safete Hadergjona – ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, neni 29, thotë se në afatin gjashtë mujor duhet të nxjerren aktet nënligjore, që përcaktojnë numrin e përfituesve dhe të kalkulohet kostoja buxhetore dhe të përfshihet në ligj dhe të ndahet buxheti. Aktet nënligjore nuk janë nxjerrë dhe deri sa të kryhen procedurat nuk e di se si mund të përfshijmë tani në ligjin e buxhetit.

Agim Krasniqi – njoftojë se për dy rastet e mëhershme ka qenë pjesa tekstuale dhe ka pasur numra. Duhet të krijohen kushtet dhe të bëhet verifikimi për tu ndarë buxhet pastaj. Në marrëveshje me FMN-në për të filluar me zbatue këtë ligj, pa u ditur kostoja buxhetore, nuk ka.

Visar Ymeri – theksoi se ligji për buxhet nuk ndërton mekanizma verifikimi për asnjë çështje, ato i ndërtojnë ligjet e veçanta. Ne nuk kemi të drejtë të suspendojmë ligjet, dhe nëse kjo çështje është e mbështetur në ligj, atëherë duhet të figurojë edhe në ligjin për buxhet, dhe pastaj si Kuvend të kërkojmë përgjegjësi nga qeveria për moszbatimin e ligjit, siç është në këtë rast krijimin e mekanizmave verifikues për çështjet e caktuar.

Pas diskutimeve, Komisioni nuk përkrahu amendamentin 1 të propozuar nga katër deputetët (Vjosa Osmani, Armend Zemaj, Doruntina Maloku dhe Arben Gashi), dhe njëzëri vendosi që raportit të komisionit, ti shtohet edhe një amendament i ri 6, me tekstin si në vijim:

“Në Neni 12, shtohet paragrafi i ri 8, me tekstin si në vijim: 8. Qeveria obligohet që të krijoj mundësitë për implementimin e Ligjit për Skemat Pensionale nr. 04/L-131 të Financuara nga Shteti, sipas Nenit 8, paragrafi 6 dhe nenit 29 të ligjit në fjalë”.

Kryetari konstatoi se komisioni me shtatë vota Kundër, dy vota Për (Visar Ymeri dhe Donika Kadaj-Bujupi), dhe asnjë Abstenim, nuk u përkrahu amendamentin 2, i propozuar nga katër deputetët (Vjosa Osmani, Armend Zemaj, Doruntina Maloku dhe Arben Gashi).

Safete Hadergjona – theksoi se në amendamentin 18, është bërë një lëshim. Pika 6, që ka të bëjë me “Renovimi i Palestrave ekzistuese sportive në qendrat regjionale me shumë 200,000€, ndryshohet në 350,000€”, duhet të fshihet, dhe pika 8, që bëhet pika 7, dhe që ka të bëjë me projektin “Ndërtimi i Palestrës Sportive ne Samadrexhe në Komunën e Vushtrisë, shuma 0 €, duhet të bëhet 150,000€.

Sipas propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi, që në amendamentin 18, të fshihet pika 6 “Renovimi i Palestrave ekzistuese sportive në qendrat regjionale me shumë 200,000€, ndryshohet në 350,000€”, ndërsa në pikën 8 që bëhet pika 7, dhe Projekti “Ndërtimi i Palestrës Sportive ne Samadrexhe në Komunën e Vushtrisë, shuma 0 €, bëhet 150,000€.

2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar nga data 01.01.2015 deri më 31.12.2015

Kryetari – sqaroi shkurtimisht përmbajtjen e propozim-vendimit të Qeverisë.

Në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni me shtatë vota Për, dy vota Kundër (Visar Ymeri dhe Donika Kadaç-Bujupi), dhe asnjë Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar, nga data 01.01.2015 deri më 31.12.2015, në pajtim me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Komisioneve tjera të përhershme lidhur me Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa

Kryetari – njoftoi se deri tani kemi pranuar dy raportet me rekomandime të komisioneve të përhershme, nga Komisioni për Integrime Evropiane dhe Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, dhe nga përmbajtje e raporteve, nuk shihet se ka ndonjë amendament apo propozim konkret, që do të na obligonte të deklarohejmë si komision funksional. Raporti me rekomandime i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ende nuk na është dorëzuar, dhe unë mendoj që nëse ka ndonjë propozim apo amendament konkret, ne si komision funksional të mos e përkrahim, dhe le të diskutohet dhe të vendoset në seancë.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që në rast të amendamenteve apo propozimeve eventuale të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, të mos i përkrah, dhe për amendamentet apo propozimet eventuale, të vendoset në seancë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani